

VENDIM
Nr. 5, datë 6.1.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE TË PROCEDURAVE PËR
PËRFITIMET NGA PROGRAMI I GRANTEVE TË RINDËRTIMIT DHE
PROJEKTET MODEL**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës dhe të neneve 18, 19, 20 e 25, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim parashikon rregullat për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit, nëpërmjet miratimit të projekteve model, masën e përfitimit të granteve të rindërtimit të shtëpive individuale të banimit ose të rikonstruksionit të banesave, ndërtesave ose shtëpive individuale të banimit, kushtet, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për shpërndarjen e granteve dhe mbikëqyrjen e zbatimit të kontratave përkatëse, sipas parashikimeve në nenin 25, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

2. Subjektet përfituese janë individët dhe familjet, të cilët kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë mbetur të pastrehë dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat ose shtëpitë individuale të banimit, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore si dhe të gjitha subjektet e tjera, sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

II. PROCEDURA E MIRATIMIT TË PROJEKTEVE MODEL, KUSHTET, KRITERET DHE AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR VLERËSIMIN E APLIKIMEVE

1. Njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përgjegjës që caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave është organi i ngarkuar me detyrën e administrimit të granteve për rindërtimin, sipas projekteve model të shtëpive individuale që janë shembur ose duhen shembur ose grante për rikonstruksionin e shtëpive individuale dhe banesave në ndërtesa të cilat janë klasifikuar si objekte të dëmtuara ose të pabanueshme.

2. Transferimi i fondit për grantet e rindërtimit te njësitë e vetëqeverisjes vendore ose tek autoriteti shtetëror përgjegjës bëhet me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozim të ministrit të Shtetit për Rindërtimin.

3. Njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përgjegjës harton listën e nevojave për grante rindërtimi në territorin në territorin përkatës dhe paraqet kërkesën për grante për rindërtimin e shtëpive individuale ose rikonstruksionin e shtëpive individuale dhe banesave në ndërtesa në bazë të aktekspertizës së thelluar ose të aktkonstatimeve përkatëse, pranë Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, si autoriteti përgjegjës i cili shqyrton mundësinë për përdorimin e fondit të rindërtimit për këto qëllime.

Njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përgjegjës dorëzon në Komisionin Shtetëror të Rindërtimit informacionin e plotë në lidhje me llojet e granteve, buxhetet përkatëse që nevojiten dhe arsyetimin e përzgjedhjes së programit të granteve të rindërtimit, për plotësimin e nevojave që parashtron.

4. Rindërtimi i shtëpive individuale bëhet sipas projekteve model të ndërtimit, të hartuara nga inxhinierë të licencuar, studio projektimi apo subjekte të tjera, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi. Kostot për këto shërbime mbulohen nga fondi i rindërtimit dhe prokurimi i shërbimeve kryhet nga Enti Kombëtar i Banesave, sipas procedurave që parashikohen në aktin normativ nr. 9, datë

16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, dhe janë pjesë përbërëse e kërkesës për financimin e granteve që parashikohet në pikën 3, të këtij vendimi, si dhe për ndërtimin e çdo objekti të ri në bazë dhe në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit. Në zbatim të parashikimeve të këtij vendimi, Enti Kombëtar i Banesave prokuron të paktën 3 (tri) projekte model, duke specifikuar në dokumentet përkatëse të procedurës së prokurimit kërkesat specifike për secilin model.

Projektet model duhet të ndjekin parimet e arkitekturës modulare dhe t'i përgjigjen qasjes për rindërtim në afate kohore sa më të shkurtra, me cilësi të lartë teknike gjatë zbatimit.

5. Projektet model:

5.1 I nënshtrohen oponentëve teknike dhe miratohen nga Instituti i Ndërtimit, sipas legjislacionit në fuqi, duke respektuar kushtet teknike të projektimit, kodet dhe eurokodet dhe duhet të përmbajnë:

- a) projektin arkitektonik;
- b) projektin konstruktiv;
- c) projektin e instalimeve hidrosanitare, elektrike, të ngrohjes dhe të ftohjes;
- ç) skemën e lidhjes së projektit me infrastrukturën publike;
- d) skemën e themeleve të projektit;
- dh) preventivin përkatës referuar kostove të ndërtimit, të miratuara nga Enti Kombëtar i Banesave.

5.2 Përfaqësojnë shtëpi individuale me sipërfaqe:

- a) jo më pak se 60 m² deri në 70 m²;
- b) jo më pak se 70 m² deri në 80 m²;
- c) jo më pak se 90 m².

6. Enti Kombëtar i Banesave kryen procedurat dhe merr në dorëzim projektet model, jo më vonë se dy muaj nga data e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

7. Projektet model, sipas pikës 5, të këtij vendimi, përdoren për zbatimin e çdo projekti që realizohet në kuadër të procesit të rindërtimit nga njësitë zbatuese ose donatorët, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në marrëveshjen ndërmjet donatorëve dhe Këshillit të Ministrave.

8. Përjashtimisht parashikimeve të pikës 5, të këtij vendimi, projekt model mund të konsiderohet dhe projekti që realizon vetë subjekti që kërkon përfitimin e grantit, me kusht që të plotësojë kërkesat dhe standardet sipas parimeve të procesit të rindërtimit dhe sipas parashikimeve të këtij vendimi. Vlera e grantit dhe në këto raste përlllogaritet sipas parashikimeve të kreut III, të këtij vendimi.

9. Aplikimi për të përfituar nga grantet e rindërtimit të shtëpive individuale bëhet nga përfituesit drejtpërdrejt në strukturën përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose në zyrën e qëndrimit me një ndalesë të njësisë së vetëqeverisjes vendore, nëse ka një të tillë sipas modelit të aplikimit të miratuar, bashkëlidhur këtij vendimi, si shtojca A ose tek autoriteti shtetëror përgjegjës i përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

10. Aplikimi bëhet në formë të shkruar dhe regjistrohet në një sistem elektronik të dhënash.

11. Aplikuesi ka të drejtën të zgjedhë njërin prej projekteve model të miratuara nga Instituti i Ndërtimit ose të kërkojë përfitimin e grantit sipas parashikimeve të pikës 8, të këtij vendimi.

12. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë, administrojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave për individët dhe familjet të cilët kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe kanë aplikuar për të përfituar nga programi i granteve të rindërtimit.

13. Njësitë e vetëqeverisjes vendore regjistrojnë aplikimet në një sistem elektronik, i cili jep mundësinë e përpunimit të të dhënave, si më poshtë vijon:

- a) emrin, atësinë, mbiemrin;
- b) numrin e aplikimit;
- c) datën e dorëzimit/paraqitjes së aplikimit;
- ç) objektin e kërkesës, përfshirë edhe preferencën e paraqitur për të përfituar nga programi i grantit të rindërtimit dhe tipi i projektit model të zgjedhur ose projektin e kryer vetë nga kërkuesi/aplikanti;
- d) adresën e kërkuesit;

dh) Përbërjen familjare në momentin e aplikimit;

e) aktekspertizën e thelluar, të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose çdo person, fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar ndërtesa e shpallur si e pabanueshme;

ë) çdolloj dokumentacioni që provon të drejtat e pronësisë mbi objektin e dëmtuar;

f) të dhënat e llogarisë bankare të kërkuesit pranë një banke të nivelit të dytë.

14. Në qoftë se aplikimi paraqet mangësi të të dhënave, sipas parashikimeve të këtij vendimi, struktura/t përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përkatës, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e regjistrimit të aplikimit, i kërkon/jnë me shkrim aplikantit të korrigjojë pasaktësitë, duke përcaktuar edhe afatën e nevojshëm për plotësimin e tyre. Struktura/t përgjegjëse ofron/jnë ndihmë aktive për plotësimin e formularëve të aplikimit për përfitimin nga programi i granteve të rindërtimit për cilindo aplikues, duke u kujdesur që çdo individ/familje të marrë informacionin dhe ndihmën e nevojshme për këtë qëllim.

15. Çdo individ/familjeje që aplikon, në çdo rast, i lëshohet një vërtetim që konfirmon regjistrimin e aplikimit, objektin e tij, datën dhe listën e dokumenteve të bashkëlidhura, nëse ka të tilla, sipas formatit që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca B.

16. Njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përgjegjës për miratimin e kërkesave të aplikantëve ndjek procedurat, si më poshtë vijon:

a) klasifikon aplikimet sipas projekteve model;

b) mbledh cilindo prej dokumenteve për të dhënat që parashikohen në pikën 10, të këtij vendimi, që e mbajnë organet publike në vend, duke përjashtuar aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre;

c) bën verifikimin e dokumentacionit të aplikantit, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e dorëzimit;

ç) harton dhe miraton listën e përfituesve;

d) njofton familjet që përfitojnë nga grantet e rindërtimit, si dhe ata/o që nuk kanë përfituar, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e miratimit të listës nga kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose nga autoriteti përgjegjës shtetëror. Aplikantët që nuk kanë fituar caktohen të përfitojnë nga një program tjetër i procesit të rindërtimit, për aq sa është e mundur;

dh) harton kontratën model të grantit që lidhet midis njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoritetit shtetëror dhe përfituesit sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për kontratat e granteve/dhurimeve apo të ngjashme me to.

17. Kriteret e përparësisë për renditjen e përfituesve janë, si më poshtë vijon:

a) familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore;

b) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;

c) familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara;

ç) të moshuarit, të cilët kanë mbushur moshën e pensionit;

d) familjet në skemën e ndihmës ekonomike;

dh) të rënë në krye të detyrës.

18. Përfitues të granteve të rindërtimit janë individët ose familjet shtëpitë individuale të të cilëve duhen ndërtuar nga e para, sipas parashikimeve në aktekspertizën e thelluar. Masa e grantit llogaritet sipas parashikimeve të kreut III, të këtij vendimi.

19. Aplikantëve jofitues, struktura përgjegjëse u njofton edhe arsyet e kësaj vendimmarrjeje si dhe të vendimit për përfitim nga një program tjetër i procesit të rindërtimit, nëse kjo është e mundur. Aplikantët jofitues mund të paraqesin ankesat e tyre pranë kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose pranë autoritetit përgjegjës, brenda 5 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.

20. Dosja e çdo aplikanti duhet të përmbajë dokumentacionin që vërteton deklaratimet e bëra në momentin e aplikimit. Dokumentacioni i kërkuar, sipas këtij vendimi, që mbajnë apo përgatisin organet publike në vend, sigurohet nga vetë struktura/t përgjegjëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës, duke përjashtuar aplikantin nga detyrimi për paraqitjen e tyre.

Aplikanti depoziton deklaratën e pëlqimit për mbledhjen e informacioneve/dokumenteve të lidhura me të, sipas formatit tip që i bashkëlidhet këtij vendimi, si shtojca C. Nëse aplikanti nuk e dorëzon apo refuzon të firmosë këtë deklaratë, struktura/t përgjegjëse shkarkohet/n nga detyrimi i mbledhjes së dokumentacionit dhe ky detyrim i kalon vetë aplikantit. Dokumentacioni i nevojshëm sigurohet me shpenzimet e njësisë së vetëqeverisjes vendore, e cila, nëse është e nevojshme, mund të lidhë marrëveshje me strukturat përkatëse, në funksion të lehtësimit të marrjes së dokumentacionit.

21. Për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programi i granteve të rindërtimit, në bazë të kriterëve të përcaktuara në këtë vendim, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore ose autoriteti përgjegjës krijon një komision të posaçëm, i cili vlerëson kërkesat në bazë të dokumentacionit të kërkuar, sipas këtij vendimi.

22. Komisioni i paraqet kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose titullarit të autoritetit shtetëror përgjegjës raportin e plotë me propozimin për subjektet përfituese dhe ata që nuk plotësojnë kriteret për përfitim. Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore ose titullari i autoritetit përgjegjës vendos brenda 10 (dhjetë) ditëve pune listën e fituesve.

23. Organet e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përgjegjës bëjnë publike, nëpërmjet mjeteve të informimit publik në faqet e tyre të internetit dhe shpalljes në vende të dukshme, pranë institucionit të tyre:

- a) kërkesat që duhen plotësuar për t'u trajtuar nga programet e granteve të rindërtimit;
- b) personat përgjegjës me të cilët duhet kontaktuar për plotësimin dhe ndryshimin e të dhënave të formularit apo për çdo sqarim tjetër për plotësimin e tij;
- c) dokumentacionin që kërkohet për verifikimin e të dhënave që deklaron subjekti i interesuar;
- d) procedurën që ndiqet nga njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti shtetëror përgjegjës për miratimin e përfituesve;
- dh) organin ankimor, të cilit duhet t'i drejtohet subjekti që nuk është përzgjedhur si fitues si dhe afatet kohore.

24. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet shtetërore përgjegjëse marrin të gjitha masat e mundshme që informimi publik të jetë i aksesueshëm dhe i kuptueshëm për të gjithë individët.

25. Me përfundimin e aplikimeve dhe hartimin e listës së përfituesve bëhet publikimi i saj pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore si dhe i dërgohet njoftim zyrtar subjektit përfitues.

26. Përfituesit pajisen me lejet përkatëse për ndërtimin, sipas parashikimeve të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", pas nënshkrimit të kontratës së grantit.

27. Kontrata përkatëse për grantin përmban, përveç të tjerave, dhe detyrimet e përfituesit që ta përdorë grantin për qëllimet e miratuara dhe të zbatojë afatet që parashikohen në lejet përkatëse të ndërtimit si dhe penalitetet në rastet e mospërmbushjes së detyrimit, që përfshijnë por nuk kufizohen edhe në kthimin e grantit kur konstatohen abuzime nga përfituesi, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për këto kontrata.

28. Shuma e grantit të rindërtimit kalon në llogari të përfituesit, pranë një banke të nivelit të dytë, në masën 60% brenda 10 ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës së grantit dhe pjesa e mbetur e shumës pas verifikimit nga struktura përgjegjëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore apo autoriteti përgjegjës shtetëror, që vërteton se përfituesi i ka plotësuar kushtet dhe detyrimet e parashikuara në kontratën e grantit.

29. Mbikëqyrja e zbatimit të kontratës nga përfituesi bëhet nga struktura përgjegjëse e njësisë së vetëqeverisjes vendore apo autoritetit përgjegjës shtetëror për zbatimin e kontratave, e cila, në rast shkeljesh, i propozon kryetarit të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose titullarit të autoritetit përgjegjës aplikimin e penaliteteve, sipas parashikimeve të kontratës.

III. MASA E GRANTIT TË RINDËRTIMIT

1. Masa e grantit të rindërtimit përfshin:

- a) vlerën e investimit të ndërtimit;
- b) investimet për lidhjen me rrjetin kryesor të infrastrukturës si ujësjellës-kanalizime, telefoni, energji elektrike;

c) çdo shpenzim tjetër të parashikueshëm.

2. Masa e grantit llogaritet sipas tabelës A që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

IV. GRANTET PËR RIKONSTRUKSIONIN

1. Procedurat që parashikohen në këtë vendim zbatohen, për aq sa është e mundur, dhe për aplikimet, miratimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e granteve për rikonstruksionin e shtëpive individuale ose të banesave në ndërtesa (pallate), të cilat janë klasifikuar si objekte të pabanueshme ose të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime.

2. Përveç sa parashikohet në pikën 13, të kreut II, të këtij vendimi, aplikimet për grante rikonstruksioni ose riparimi duhet të shoqërohen dhe me:

a) aktin e konstatimit ose aktekspertizën e thelluar, të lëshuar nga Instituti i Ndërtimit ose grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose çdo person, fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore, në të cilin vërtetohen dëmet që ka pësuar shtëpia individuale, ndërtesa ose banesa;

b) projektin e rikonstruksionit ose listën e punimeve të riparimit, hartuar nga Instituti i Ndërtimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore, apo projektuesit e licencuar së bashku me preventivin e punimeve që kërkohen të financohen nëpërmjet grantit;

c) deklaratën e banorëve të ndërtesës (pallat) për mbulimin e shpenzimeve sipas shkronjës “c”, të pikës 7, të këtij kreu, së bashku me listën e familjeve që banojnë në ndërtesë.

3. Përfitojnë vlerën e plotë të rikonstruksionit individët ose familjet:

a) shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve, kur nuk përbëjnë raste si ato të parashikuara në pikën 18, të kreut II, të këtij vendimi dhe që janë shpallur të pabanueshme pasi janë dëmtuar në mbi 2/3 e tyre dhe/ose si pasojë e dëmtimeve të mëdha strukturore ose dëmtimeve shumë të rënda jostrukturore, janë rrezik për shembje, vërtetuar nga aktekspertiza e thelluar;

b) shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve, kur nuk përbëjnë raste si ato të parashikuara në pikën 18, të kreut II, të këtij vendimi, dhe që janë shpallur të pabanueshme pasi janë dëmtuar në mbi 2/3 e tyre dhe/ose si pasojë e fatkeqësisë natyrore kanë dëmtime shumë të rënda strukturore, vërtetuar nga aktekspertiza e thelluar.

4. Përfitojnë 50% të vlerës së rikonstruksionit ose të riparimit, por jo më shumë se 500 000 (pesëqind mijë) lekë, individët ose familjet, shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve kanë pësuar dëmtime thelbësore deri në të mëdha, që konsistojnë në çarje të moderuara në strukturë ose çarje të mëdha në mure ndarëse dhe mbushëse ose dështim i mureve ndarëse dhe perimetralë, siç përcaktohet nga aktekspertiza e thelluar.

5. Përfitojnë 50% të vlerës së rikonstruksionit ose të riparimit, por jo më shumë se 250 000 (dyqind e pesëdhjetë mijë) lekë, individët ose familjet, shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve kanë pësuar dëmtime të lehta strukturore ose dëmtime të moderuara jostrukturore ose çarje në muret ndarëse dhe perimetralë, siç përcaktohet nga aktkonstatimi ose aktekspertiza e thelluar.

6. Përfitojnë 50% të vlerës së rikonstruksionit ose të riparimit, por jo më shumë se 100 000 (njëqind mijë) lekë, individët ose familjet, shtëpitë individuale ose banesat e të cilëve nuk kanë dëmtim strukturor ose kanë dëmtim të papërfillshëm deri në të lehtë jostrukturor, si çarje të lehta në mure ndarëse dhe perimetralë, siç përcaktohet nga aktkonstatimi ose aktekspertiza e thelluar. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e nënshkrimit të kontratës së grantit, shuma e plotë e grantit të rindërtimit i kalon përfituesit në një llogari bankare pranë një banke të nivelit të dytë.

7. Granti për rikonstruksion ose riparim të mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesë (pallat):

a) Në rast se dëmtimet që kanë nevojë për rikonstruksion ose riparime në ndërtesa (pallate) me njësi banimi duhen kryer dhe në mjedise të përbashkëta ose në bashkëpronësi të ndërtesës, pjesa përkatëse e grantit të rikonstruksionit ose riparimit përkatës kërkohet me aplikim nga administratori i pallatit, i certifikuar sipas legjislacionit në fuqi, dhe llogaritet nga njësia vendore ose autoriteti përgjegjës veçmas nga granti që përfitojnë individët ose familjet për banesat e tyre të dëmtuara;

b) Masa e grantit për punimet që parashikohen në shkronjën “a”, të pikës 7, të këtij kreu, është 50% e vlerës së rikonstruksionit ose riparimit;

c) Administratori i certifikuar është përgjegjës për realizimin e punimeve, për të cilat miratohet granti. Në rast se nuk ka administrator të certifikuar për ndërtesën (pallatin) ose kur administratori i certifikuar nuk kryen aplikimin, brenda 3 muajve nga data e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, granti për punimet që parashikohen në shkronjën “a”, të pikës 7, të këtij kreu, kërkohet me aplikim nga një apo më shumë banorë të ndërtesës dhe realizohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore, me kusht që pronarët e njësisë të banimit në ndërtesën që duhet rikonstruktuar apo riparuar të investojnë vlerën shtesë mbi masën e grantit që përfitohet, e nevojshme për realizimin e punimeve përkatëse.

V. DISPOZITË E FUNDIT

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Enti Kombëtar i Banesave dhe organet e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

Tabelë A

Përbërja familjare	Sipërfaqja në metër katrorë (m ²)	Masa e grantit
Deri në 2 anëtarë	60 m ² deri në 70 m ²	Preventivi i projektit model
2 deri në 4 anëtarë	70 m ² deri në 80 m ²	Preventivi i projektit model
5 e më shumë anëtarë	Jo më pak se 90 m ²	Preventivi i projektit model

SHTOJCË A

FORMULAR APLIKIMI PËR TË PËRFITUAR NGA PROGRAMI I GRANTEVE TË RINDËRTIMIT

Emri i aplikantit	Emri dhe mbiemri i aplikantit
PËR TË PLOTËSUAR NGA NËPUNËSIT	
NR. PROTOKOLLI DHE DATA E APLIKIMIT	
NR. IDENTIFIKUES I APLIKIMIT	

Aplikanti:

Udhëzime. Ju lutemi plotësoni formularin me të gjithë informacionin e kërkuar. Bëni kujdes që të gjitha të dhënat personale të jenë të sakta në mënyrë që të lehtësoni procesin e kontrollit administrativ të formularit të aplikimit tuaj. Gjithashtu, mos harroni që të vendosni firmën në fund të formularit.

1.1 Emri dhe kontaktet

Emri i aplikantit	<Emri dhe mbiemri i aplikantit>
Nr. pasaportës ose i kartës së identitetit të aplikantit	
Adresa e vendbanimit	< fshati/ qyteti >
Numri i telefonit	< telefon fiks dhe celular >
Objekti i kërkesës, preferenca dhe modeli i projektit të rindërtimit të zgjedhur	
Përbërja familjare	

Aktekspertiza e thelluar mbi pasurinë e dëmtuar ose akti i konstatimit	
Dokumentacion mbi pronësinë	
Nr. i llogarisë bankare pranë një banke të nivelit të dytë	
Nr. pasaportës ose i kartës së identitetit të përfaqësuesit ligjor (nëse ka)	
E-mail-i i aplikantit:	
Adresa e korrespondencës dhe kontaktet e përfaqësuesit ligjor (nëse e ka)	< fshati/ qyteti, rrethi >
	Tel: _____ e-mail _____

(Emri dhe mbiemri i aplikantit)
(nënshkrimi)

SHTOJCË B
VËRTETIM QË KONFIRMON REGJISTRIMIN E APLIKIMIT, OBJEKTIN, DATËN
DHE LISTËN E DOKUMENTEVE TË BASHKËLIDHURA

Vërtetim regjistrimi kërkesë (njësia e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore)

Nr. ____ prot, më ____ . ____ .2020

Lënda: Vërtetim regjistrimi kërkesë për t'u trajtuar nga programi i granteve të rindërtimit

Drejtuar: Z./Znj.....

(adresa)

I nderuar Z./Znj.....,

Vërtetojmë së ju keni paraqitur kërkesën me nr. ____ prot, datë _____, e cila është regjistruar pa të meta pranë (njësia e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore), me anë të cilës paraqisni kërkesën tuaj për t'u trajtuar nga programi i granteve të rindërtimit.

Kërkesa juaj është regjistruar me nr. _____, në regjistrin elektronik të të dhënave. Bashkëlidhur kësaj kërkesë janë depozituar edhe dokumentet, si më poshtë vijon:

	Titulli i dokumentit	Nr. i faqeve

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

(emri i punonjësit, firma)

SHTOJCË C
DEKLARATË PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE,
AKSESIN PËR NJOHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

DEKLARATË
PËR DHËNIEN E PËLQIMIT PËR MBLEDHJEN E TË DHËNAVE, AKSESIN PËR
NJOHJEN DHE ADMINISTRIMIN E TË DHËNAVE PERSONALE

Unë _____, i biri i/e bija e _____ dhe i/e _____, lindur më _____, në _____, dhe banues/banuese në _____, me shtetësi _____, me numër identifikimi _____, me vullnetin tim të lirë,

DEKLAROJ SE:

Mbështetur dhe në zbatim të:

- vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave dhe procedurave për përfitimet nga programi i granteve të rindërtimit”
- aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”;
- ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

Deklarimi	Firma (në kutinë që aplikanti dëshiron të plotësojë)
<p>- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës _____, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave.</p> <p>- Jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</p> <p>- Jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura në referim të pikës _____, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për trajtimin e kërkesës sime për t'u trajtuar me programet e granteve të rindërtimit, të parashikuara në nenet 18 dhe 25, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.</p>	
<p>- Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhënat e nevojshme, sipas parashikimeve të pikës _____, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave;</p> <p>- Nuk jap pëlqimin që të mblidhen të dhëna dhe të kryhen procedurat e verifikimit të këtyre të dhënave.</p> <p>- Nuk jam dakord që të dhënat e mia personale të mbledhura, në referim të pikës _____, të vendimit nr. _____, datë _____, të Këshillit të Ministrave, të trajtohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për trajtimin e kërkesës sime për t'u trajtuar me programet e granteve të rindërtimit, të parashikuara në nenet 18 dhe 25, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.</p>	

_____, më _____.____.2020____

DEKLARUESI

